

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Xh. M., nga ..., të cilin e përfaqëson N. H., avokat në ..., kundër të paditurit N. D., nga ..., për kompensim dëmi, përkritazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3385/2015 datë 25.3.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.6.2019, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3385/2015 datë 25.3.2019.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3385/2015 datë 25.3.2019, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Pejë, C.nr.594/13 datë 19.6.2015, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri t'ia paguaj shumën prej 4,500 €, në emër të borxhit, me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. M., nga ..., që i padituri N. D., nga ..., të detyrohet që paditësit t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 360 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Me pjesën III të dispozitivit detyrohet i padituri që ta dorëzoj shumën prej 4,500 € (katërmijepesëqind €) të fituar nga puna e ndaluar Komunës së Skenderajt, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë dhe me pjesën IV të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi ka paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohen ose ato të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e kundërshtuar konform nenit 215 të LPK-së, dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi dhe i padituri nuk kanë kundërshtuar faktin se në bazë të marrëveshjes paraprake i padituri ka marrë për detyrim që në mënyrë ilegale tua mundësojë kalimin e kufirit nga Kosova për në Austri paditësit dhe pesë anëtarëve tjerë të familjes. Me rastin e arritjes së marrëveshjes paditësi të paditurit ia ka dhënë shumën prej 4500 €, ndërsa pas arritjes në Austri për pjesën tjetër të shpërblimit i padituri ka pas me marrë një kamion dhe një veturë në vlerë prej 3500 €, mirëpo të njëjtit janë zbuluar nga policia kufitare. Këtu i padituri, nga Gjykata e Qarkut në Gjilan me aktgjykimin P.nr.91/2011 datë 30.6.2011 është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 12 muaj, për shkak të veprës penale kontrabandimi me emigrant, nga neni 138 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK –ës.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar ngase baza e marrëveshjes gojore e lidhur ndërmjet palëve për kalimin ilegal të kufirit është e palejuar, andaj marrëveshja si e tillë është nule për faktin se e njëjta është në kundërshtim me ligjin dhe rendin kushtetues dhe nuk gëzon mbrojtje juridike.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke gjetur se ajo ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, në bazë të së cilës ka zbatuar drejt procedurën kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Kjo nga fakti se paditësi dhe i padituri kanë qenë në dijeni se marrëveshja gojore e lidhur në mes tyre për kalimin ilegal të kufirit është e palejuar. Andaj, Gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejt kanë zbatuar nenin 47 të LMD –ës, i cili parasheh se *''Kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është nul''*, dhe nenin 51 të ligjit të cekur, i cili

parasheh se *''Secili detyrim duhet të ketë bazën e lejueshme. Baza është e palejueshme po qe se është në kundërshtim me parimet e rregullit shoqëror, të përcaktuara në kushtetutë me dispozitat e dhunshme dhe me rregullat e moralit të shoqërisë vetëqeverisëse socialiste''.*

Pretendimin e cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar nenin 104 par. 2 të LMD –ës kur kanë vendosur që të obligohet i padituri shumë prej 4500 €, t'ia dorëzojë Komunës së Skenderajt, të fituara nga puna e ndaluar, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raporteve ka përcaktuar se : *'' Mirëpo, në qoftë se kontrata është nul për shkak se sipas përmbajtjes ose qëllimit të vet është në kundërshtim me parimet e përcaktuara në kushtetutë të rregullit shoqëror me dispozitat e detyrueshme ose me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste gjykata mund ta refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e palës së pandërgjegjshme e asaj që ia ka dhënë palës tjetër, e mundet edhe të vendosë që pala tjetër t'ia dorëzojë komunës ate që ka marrë të bazë të kontratës së ndaluar në teritorin e së cilës ndodhet selia, respektivisht vendbanimin e saj.''*

Në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret me të cilin do të vihet në pyetje ligjshmëria e aktgjykimit të kundërshtuar, ndërsa Gjykata Supreme revizionin e shqyrton konform nenit 215 të LPK –ës, vetëm në pjesën e goditur me revizion dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejt të drejtës materiale, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Për arsyet e lartpërmendura me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.178/2019 datë12.6.2019

Kryetare e kolegjit,  
Emine Kaçiku